

Prishtinë, 25/10/2024

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 25.10.2024, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR. 21/2024/25 I KOMISIONIT TË GARAVE

- I. Komisioni i Garave ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga KBF Vëllaznimi-Gjakovë për regjistrimin e lojtareve Gresa Berisha, Erisa Nimani dhe Elda Mulhaxha që janë lojtare të KBF Peja03 si lojtar me licencë të dyfishtë jashtë afatit kalimtar.
- II. Komisioni i garave pas shqyrtimit të kësaj kërkesë e bazuar në Rregulloren për regjistrim dhe kalim të FBK-ës 2024/2025, MIRATON kërkesën e KBF Vëllaznimi-Gjakovë.
- III. Vendimi hyn në fuqi nga data e publikimit

ARSYETIM

Gjatë vendimmarrjes lidhur me Vendimin Nr. 21/2024-25, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

- (a) KBF Vëllaznimi-Gjakovë ka paraqit kërkesë për regjistrimin e lojtareve Gresa Berisha, Erisa Nimani dhe Elda Mulhaxha që janë lojtare të KBF Peja03 si lojtare me licencë të dyfishtë jashtë afatit kalimtar.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT




FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina

- (b) Lidhur me kërkesën e KBF Vëllaznimi-Gjakovë, nga shkresat e prezantuara shihet se të njëjtat janë nën moshën 21 vjeçare, andaj në përputhje me nenin 34 pika 1 dhe 4 në Rregulloren për regjistrim dhe kalim të FBK-së 2024/2025, u miratua ky regjistrim i lojtarëve Gresa Berisha, Erisa Nimani dhe Elda Mulhaxha.

Në emër të Komisionit të Garave të FBK-së,

Armend **HAMITI**
Kryetar i Komisionit



Federata e Basketbollit të Kosovës

KËSHILLË JURIDIKE:

Në pajtim me *Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2024/2025, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.*



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina